

ENTI RREGULLATOR I ENERGISË  
SEKRETARIA

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .10.2020

**Për mbledhjen Nr. 38, datë 22.10.2020, ora 13:30  
Të Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 22.10.2020, ora 13:30** do të zhvillohet mbledhja nr. 38 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

- 1- Mbi shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020, dhe përditësimin e planit dhjetëvjeçar 2015-2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.
- 2- Mbi aplikimin e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021
- 3- Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror”
- 4- Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Kodit të matjes të gazit natyror”
- 5- Për miratimin e procedurës mbi miratimin e “Kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundor që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit”
- 6- Mbi procedurën e licencimit të shoqërisë “Koka & Ergi Energji Stavec” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike
- 7- Mbi kërkesën për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.09.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Sekë” me kapacitet të instaluar 12667 kW dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kW, me kapacitet total të instaluar 14962 kW.”

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i

shkaktuar nga COVID-2019”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**